

**INSTITUTI I STUDIMEVE PEDAGOGJIKE**

**PROGRAMI I LËNDËS  
SË EDUKIMIT MUZIKOR**

**Klasa II**

**CIKLI FILLOR I SHKOLLËS 9-VJEÇARE**

**TIRANË, 2004**

## **Hyrje**

Në klasën e dytë njohuritë mbi elementet muzikore do të rimerren duke i rigjetur në klasë ose në mjedise të tjera dhe duke i zbatuar ato te këngët, lojërat, dëgjimet e ndryshme. Këto njohuri muzikore që do të pasurohen me njohuri të reja, nxënësi do t'i zbatojë gjatë të kënduarit, luajtjes me instrumente të ndryshme me goditje dhe ORF\*, përjetimt të muzikës dhe shprehjes së saj, në bashkëveprim me mjete të arteve të tjera. Pra, edhe në këtë nivel, njohuritë muzikore janë të lidhura ngushtë dhe gjejnë zbatim në praktikën muzikore. Ato realizohen duke u ndërthurur përmes veprimtarive praktike muzikore në klasë, shkollë ose auditore të ndryshme.

## **I. SYNIMI**

Mësimi i muzikës në klasën e dytë të arsimit të detyruar 9-vjeçar synon të aftësojë nxënësit për të përjetuar dhe për t'u shprehur nëpërmjet muzikës.

Ky program synon të kultivojë shprehitë për të kënduar, për të dëgjuar, për të luajtur, për të krijuar si dhe për t'u shprehur duke vlerësuar muzikën.

Mësimi i muzikës ka për qëllim që nxënësit në fund të klasës së dytë:

- Të rinjohin ritmin në mjedisin e tyre dhe në muzikë;
- Të rinjohin elementet dhe konceptet muzikore, nëpërmjet shembujve të thjeshtë nga jeta e përditshme dhe muzika që këndojnë dhe dëgjojnë;
- Të këndojnë këngë didaktike të thjeshta për fëmijë dhe me një tematikë të larmishme;
- Të rikujtojnë shprehitë e të kënduarit;
- Të këndojnë me intonacion dhe shprehje;
- Të luajnë lojëra të ndryshme muzikore;
- Të shoqërojnë këngët apo lojërat muzikore me instrumente të thjeshta ritmike, si: gurë, shkopinj, shuplaka, ORF etj;
- Të dallojnë vetitë e tingullit në këngë ose pjesë të thjeshta muzikore;
- Të dëgjojnë pjesë muzikore, vokale dhe instrumentale, duke dalluar timbrin e zërave dhe instrumenteve;
- Të përjetojnë muzikën nëpërmjet të arteve të tjera, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë muzikore për këtë nivel.

Edukimi muzikor në klasën e dytë synon të formojë nxënësit si përjetues të muzikës duke shprehur nëpërmjet saj botën e tyre emocionale.

## **LINJAT E PROGRAMIT**

1. Këndimi & lojëra muzikore
2. Bazat e arsimit muzikor
3. Luajtja në instrument
4. Dëgjim muzikor
5. Shprehje dhe krijim muzikor

## PROGRAMI ANALITIK PËR KLASËN E DYTË

35 javë x 1 orë = 35 orë

1. Këndim &	18 orë
Lojra muzikore	4 orë
2. Bazat e arsimimit muzikor	3 orë
3. Dëgjim muzikor	3 orë
4. Luajtje në instrument	2 orë
5. Shprehje dhe krijim muzikor	3 orë
6. OD	2 orë

### OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Objektivat e programit do të zërthehen për çdo linjë si më poshtë:

LINJA I. Këndim 18 orë

Në këtë linjë nxënësit duhet:

- të këndojnë këngë të thjeshta për fëmijë: tematike, didaktike dhe të krahinës;
- të demonstrojnë dhe të zbatojnë shprehitë vokale gjatë të kënduarit, si:
  - rregullat e frymëmarrjes,
  - qëndrimi drejt,
  - diksioni,
  - këndimi me ndjenjë,
  - shqiptimi i saktë i tekstit etj.;
- të këndojnë me intonacion të saktë;
- të këndojnë solo;
- të këndojnë në grup (ansambël/kor);
- të këndojnë dhe të interpretojnë në mënyrë shprehëse, duke treguar se e kanë kuptuar tekstin e këngës;
- të shfaqin shijet e tyre për këngë të ndryshme (këngë për fëmijë -shqiptare ose të huaja dhe të krahinës);

Objektiv social

- të respektojnë mendimin dhe shijet e të tjerëve për këngët që ata zgjedhin;
- të shprehin mendimin rreth muzikës që këndojnë.

Lojëra muzikore 4 orë

- të interpretojnë 2 – 3 lojëra muzikore, duke i shoqëruar me vegla ritmike ose ORF, apo duke ndërthurur muzikën me lëvizjet.

LINJA II. Bazat e arsimimit muzikor 3 orë

Në këtë linjë nxënësit duhet:

- të zhvillojnë ndjenjën ritmike dhe melodike të këngët, lojërat dhe pjesë të ndryshme muzikore;
- të gjejnë shembuj të ritmit në mjedis dhe në muzikë;

- të përjetojnë ritme të ndryshme tek këngët, lojërat, pjesët muzikore;
- të riprodhojnë tinguj ose zhurma me zë, trup, instrumente;
- të përcaktojnë vetitë e tingullit duke sjellë shembuj nga mjedisi i klasës dhe në muzikë:

*Lartësia:* i lartë – i ulët – më i ulët,

*Gjatësia:* i gjatë – i shkurtër – më i shkurtër,

*Ngjyra:* i lehtë - i fortë – gjysëm fort,

*Timbri:* zërat e burrave, të grave, fëmijëve apo instrumenteve të ndryshme që dëgjon

*Tempi:* ngadalë – shpejt

*Karakter* në një këngë, valle, pjese muzikore: i gëzueshëm - i qetë – i dhimbshëm;

- të krijojnë modele të thjeshta ritmike;
- të regjistrojnë gjatësi ritmike (p.sh., modele të tingujve të gjatë dhe të shkurtër në vargjet e një vjershe, me grafikë).

### LINJA III. Luajtja me instrument

2 orë

Në këtë linjë nxënësit duhet:

- të krijojnë ritme të ndryshme nëpërmjet instrumenteve me goditje;
- të njohin veglat ORF;
- të shoqërojnë këngën me vegla ritmike ose ORF.

### LINJA IV. Dëgjimi muzikor

3 orë

Në këtë linjë nxënësit duhet:

- të ridallojnë përmes dëgjimit zërat vokale: të burrave, grave, fëmijëve duke dhënë disa nga karakteristikat e tyre;
- të rinjohin disa instrumente muzikore përmes pamjes dhe dëgjimit:  
fyelli, çiftelia, lodra;
- të rinjohin pjesë muzikore, nga programi që zhvillohet në klasë si dhe nga ato që transmetohen në TV.

### LINJA V. Shprehje dhe krijim muzikor

3 orë

Në këtë linjë nxënësit duhet të:

- të përjetojnë muzikën nëpërmjet arteve të tjera: vallëzim, vizatim, poezi etj;
- të improvizojnë lëvizje të ndryshme në përshtatje me ritmin dhe melodinë;
- të gjejnë ndryshimet ndërmjet tempit, shpejt – ngadalë, duke dhënë shembuj që ndodhin në mjedisin e tyre dhe në muzikë;
- të përcjellin mendimet dhe emocionet e tyre rreth muzikës që ata dëgjojnë.

### Objektiv social

- të listojnë disa veprimtari që zhvillohen në komunitetin e tyre ose në jetën e tyre të përditshme, si: muzika e dëgjuar në televizion, festat familjare, festat apo spektaklet në krahinë apo në vend;

- të listojnë disa fjali, shprehje, që ata përdorin për të shprehur marrëdhëniet e tyre me muzikën.

Orë në dispozicion

2 orë

\*Shënim për linjën 2. Kjo linjë do t'i japë njohuritë në një mënyrë shumë të thjeshtë dhe konkrete, duke i gjetur shembujt në mjedisin e klasës apo në pjesë të thjeshta muzikore.

## METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT

Parime të përgjithshme të metodologjisë

Një vend shumë të rëndësishëm në organizimin e orës së mësimi ka formulimi i objektivave, si dhe përcaktimi i metodave që do të përdorë mësuesi, për të qenë sa më i sukseshëm dhe për të arritur objektivat e orës. Përzgjedhja e metodave mësimore bëhet nga vetë ai, në përputhje me veçoritë e moshës së nxënësve dhe të përmbajtjes së temave të ndryshme mësimore, të bazës materiale mësimore që ka në përdorim. E rëndësishme është që mësuesit të krijojnë një mjedis mësimi, i cili do t'i nxisë dhe do t'i ndihmojë nxënësit për të zbuluar dhe për të zhvilluar aftësitë dhe prirjet e tyre muzikore. Mësuesit të organizojnë veprimtari të larmishme praktike sa të jetë e mundshme, pasi shumë aftësi të përcaktuara në program duhet të arrihen nëpërmjet pjesëmarrjes në to.

Mësuesi u rikujton nxënësve të klasës së dytë modele të ndryshme ritmike apo melodike, zhurma të realitetit natyror, tinguj të muzikës, të instrumentit muzikor apo edhe të objekteve të tjera. Ai zhvillon veprimtari mësimore, si: lojëra individuale dhe në grup. Mësimi i elementeve muzikore, janë aftësi dhe shprehje që nxënësi i përvetëson nën drejtimin e mësuesit, prandaj ai duhet t'u krijojë mundësinë nxënësve për t'i kuptuar dhe për t'i praktikuar ato shumë mirë në klasë. Në drejtimin e mësuesit nxënësit në këtë nivel do të rikujtojnë konceptet e para muzikore dhe do të përvetësojnë më tej ato, duke zhvilluar kështu shprehitë për të kënduar, për të dëgjuar apo për t'u shprehur, si dhe për të bërë një analizë të thjeshtë të këngëve apo pjesëve muzikore. Niveli i dijeve, shkathtësive e shprehive të nxënësit përcaktohet jo vetëm nga përmbajtja e lëndës, por edhe nga zbatimi i udhëzimeve e kërkesave të veçanta që ka çdo klasë. Edhe në këtë klasë mësohen këngë në përshtatje me moshën për nga shtrirja (ambitusi) do – sol, dhe nga përmbajtja, me vlera didaktike, të karakterit fëmijor (natyrën, familjen, shkollën, punën, argëtimin etj.) me ritme të larmishme (vallëzues, marsh, të thjeshta, të përziera) dhe të krahinës.

Këngët e, sidomos, lojërat muzikore, zgjidhen në përshtatje me kërkesat e bazave të arsimimit muzikor për edukimin e ndjenjës ritmike dhe melodike. Çdo orë këndimi të realizojë kërkesa të bazave të arsimimit muzikor, sepse çdo orë e tillë realizohet përmes këndimit. Prandaj këndimi dhe bazat e arsimimit muzikor zhvillohen duke u ndërthurur njëri me tjetrin gjatë orës mësimore.

1. *Edukimi i ndjenjës ritmike të nxënësve.* Dukuritë ritmike përjetohen në formë konkrete dhe më pas arrihet zbatimi i tyre praktik. Mësuesi rikujton dukuritë nga natyra dhe mjedisi, p.sh.: të rrahurit e orës tik–tak, imitimi i trenit, rënia e ziles, rrahja e çekanit, e të tjera. Vazhdon me ligjërimin e gjëzave duke i shoqëruar me lëvizje ritmike ose fjalë të ndryshme të ndara në rrokje, duke i shoqëruar me shuplaka. Ai sjell në klasë modele të thjeshta ritmike dhe i zhvillon ato me

- nxënësit. Gërshetimi i ushtrimeve, me elemente ritmike në shoqërimin e këngëve dhe të lojërave të tyre fëminore janë sa më të këshillueshme.
2. *Edukimi i ndjenjës melodike.* Vazhdon të drejtohet me kujdes nga mësuesi nëpërmjet dëgjimeve konkrete me instrumente, nëpërmjet magnetofonit ose duke i gjetur (konkretizuar) ato në mjedisin e klasës. Ai zhvillon kujtesën e tyre duke rikujtuar vetitë e tingullit. Lartësia e tingujve konkretizohet jo vetëm me përfytyrime dëgjimore, por edhe pamore, kur mësuesi shkruan në dërrasë tingujt e një kënge shumë të thjeshtë duke u treguar ndryshimin e lartësisë së tingujve.
  3. *Edukimi i shprehive të kënduarit.* Shikohet e pandarë nga aftësitë dhe shprehitë e tjera në edukimin muzikor. Mësuesi rikujton shprehitë e të kënduarit duke i përsëritur ato gjatë gjithë vitit:
    - Qëndrimi drejt gjatë të kënduarit,
    - Frymëmarrja,
    - Formimi i tingullit,
    - Diksioni,
    - Dhënia e intonacionit të saktë me instrument muzikor,
    - Dirizhimi kur klasa këndon.
  4. *Edukimi dhe marrëdhëniet me instrumentet.* Vazhdon më tej puna me instrumentet me goditje dhe ORF. Këto instrumente krijojnë lidhje të afërta me artin muzikor dhe zhvillojnë njëkohësisht ndjenjën ritmike të nxënësve. Instrumenti shton interesin për lëndën, si dhe i ndihmon drejt edukimit të ndjenjës ritmike dhe melodike.
  5. *Edukimi për zhvillimin e shprehive gjatë dëgjimit.* Dëgjimi i këngëve ose pjesëve të thjeshta muzikore zhvillon rrethin e përfytyrimeve të nxënësve jo vetëm në drejtim të muzikës, por edhe në drejtim të kulturës në tërësi dhe edukon nxënësit me dëshirën për të dëgjuar. Dëgjimi është mënyra kryesore nëpërmjet të cilit nxënësi vihet në marrëdhënie me muzikën. Nga njohuritë që kanë tashmë rreth ritmit apo tingujve, ata përjetojnë emocionet që sjell pjesa apo kënga e deri në vlerësimin e saj me fjalë të thjeshta. Mësuesi vazhdon punën e tij për kultivimin e ndjenjës së të dëgjuarit të nxënësit, duke përdorur gjithashtu formën e bisedës, ku ai sqaron dhe shpjegon karakterin e pjesës, elementet muzikore, si: vetitë e tingullit, ritmin, tempin etj. Gjithashtu, mësuesi përdor metodën e krahasimit, ku, p.sh.: krahasohet një marsh me një valle, një nina – nana me një muzikë vallëzimi etj. Dëgjimi i pjesëve të shoqërohet me komentimin e tyre, duke përdorur një fjalor të thjeshtë.

## **UDHËZIME PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE**

Vlerësimi i nxënësve në këtë lëndë do të bëhet përmes përfundimeve që arrin nxënësi nga veprimtaria praktike, d.m.th. përmes të kënduarit, të luajturit, të shprehurit të muzikës etj. Vlerësimi bëhet në atë çka nxënësi ka përvetësuar dhe është i aftë të bëjë. Komponentët që do të çonin në një vlerësim të saktë të nxënësve:

1. Kupton elementet bazë të muzikës;
2. I përdor dhe i manipulon drejt ato gjatë këndimit, lojërave, dëgjimit, komunikimit dhe vlerësimit të pjesëve;
3. Komunikon dhe shpreh mendimet e tij rreth muzikës, si dhe elementeve të saj.

Mësuesi përveç standardeve të arritjes, mund të përdorë si udhëzues për përshkrimin e nivelit të nxënësve në përfundim të klasës së dytë tabelën si më poshtë vijon:

<u>Linja 1</u> Këndim	<u>Linja 2</u> Bazat e arsimimit muzikor	<u>Linja 3</u> Luajtje në instrument	<u>Linja 4</u> Dëgjim muzikor	<u>Linja 5</u> Shprehje dhe krijim muzikor
1. Zhvillon shprehitë e të kënduarit, ritmin, intonacionin, diksionin.	1. Përcakton karakterin e këngëve apo të pjesëve muzikore (shpejt, gëzuar, marsh) etj.	1. Dallon dhe riprodhon modele të thjeshta ritmike.	1. Dallon karakterin në pjesë të ndryshme që dëgjon.	1. Arrin të shpjegojë me fjalë të thjeshta karakterin e këngëve dhe emocionet që ato krijojnë tek ata.
2. Këndon me ndjenjë.	2. Identifikon shembuj të ritmit dhe të tingujve në mjedis dhe muzikë.	2. Riprodhon dhe shoqëron këngët apo lojërat me veglat me goditje.	2. Përcakton zërat e burrave, të grave, fëmijëve dhe jep disa karakteristika.	2. I përgjigjet muzikës që dëgjon nëpërmjet arteve të tjera si: vizatim, vallëzim, etj.
3. Këndon dhe shoqëron këngën me veglat me goditje ose ORF.	3. Dallon vetitë e tingullit në këngë të thjeshta feminare.	3. Ndërthur muzikën me lëvizjet trupore.	3. Dallon me lehtësi nga pamja dhe tingulli instrumentet.	3. Përdor një fjalor të thjeshtë në përjetimin e muzikës.
4. Merr pjesë në analizimin e këngëve ose pjesëve muz., duke respektuar edhe mendimin e të tjerëve.	4. Mban saktë ritmin në këngë të ndryshme		4. Shpjegon me fjalë të thjeshta karakterin e pjesëve të ndryshme që dëgjon .	4. Liston me lehtësi disa fjali për të shprehur lidhjen e tyre me muzikën.

### **INTEGRIMI**

Ky program jep mundësinë në tema të veçanta muzika të integrohet me lëndë tjera. Nxënësit mësojnë të lidhin muzikën dhe edukimin figurativ, edukimin fizik, gjuhën, historinë, gjeografinë dhe kuptojnë rëndësinë e muzikës si burim kënaqësie dhe si mënyrë komunikimi brenda një kulture dhe kulturat e tjera.

Disa tema nga linja e këngës mësuesi i klasës së dytë si njohës shumë i mirë i lëndëve mund t'i ndërthurë me lëndë të tjera.

## **MJETET MËSIMORE**

Programi i edukimit muzikor për klasën e dytë që të jetë konkret si për nxënësin, ashtu edhe për mësuesin, të shoqërohet me bazë materiale, mjete didaktike dhe burime të ndryshme. Libri i mësuesit dhe kaseta me materialet didaktike (këngë, lojëra muzikore, pjesë të ndryshme për dëgjim, shembuj të tingujve ose ritmeve të ndryshme), duhet të shoqërojnë këtë program. Gjithashtu, mjetet me përdorim kolektiv duhet të jenë: magnetofon, fizarmonikë, kaseta, postera dhe vegla me goditje, si: shkopinj, gurë, lugë, triangolo (zilka), lodër etj.

Disa udhëzime për zhvillimin e veprimtarive praktike gjatë procesit mësimor:

Lojëra didaktike që lidhen me zhvillimin ritmik dhe melodik:

- kërkon, dëgjon, dallon, krahason (zërat);
- përcakton, tinguj të ndryshëm;
- riprodhon tinguj të instrumenteve;
- riprodhon fraza nga pjesë të shkurtra dhe të thjeshta muzikore;
- krijon modele ritmike;
- këndon këngë duke përdorur gjestet, lëvizjet trupore;
- shqipton saktë zanoret dhe fjalët e këngës;

Lojëra që lidhen me veglat dhe dëgjimin:

- realizon vetëm dhe në grup lojëra me instrumentet me goditje dhe ORF, bën ushtrime për riprodhimin e tingujve me zë;
- riprodhon një frazë ose strofë duke kontrolluar ritmin dhe intonacionin;

Organizimi dhe përdorimi i mjeteve të tjera.

Nxënësit:

- krijojnë kaseta me zhurma, tinguj, zërat e shokëve etj.;
- sjellin postera të instrumenteve, të këngëtarëve, kompozitorëve etj.;
- krijojnë me ngjyrat duke pasur si frymëzim muzikën;
- përdorin veglat me goditje dhe ORF duke shpjeguar ndjesitë që u krijojnë ato;
- sjellin informacion nga festa të ndryshme në familje, qytet, shkollë etj.

## **MODELE TË REALIZIMIT TË PROGRAMIT MËSIMOR**

1. Zhvillimi i sa më shumë veprimtarive praktike përmes të kënduarit, të luajturit, të krijuarit.
2. Kultivimi për një dëgjim sa më të shpeshtë dhe me vëmendje.
3. Aktivizimi i nxënësve për të krijuar vegla të ndryshme ritmike me mjete të thjeshta.
4. Nxitja dhe aktivizimi i nxënësve për t'u shprehur me fjalë të thjeshta për këngët, pjesët të vogla muzikore dhe gjithshka që ka të bëjë me veprimtarinë muzikore në klasë dhe jashtë saj.